



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE VLORE

Nr.941 Akti

Dt.regj.23.04.2015

Nr 952Vendimi

Date 29.06.2015

### VENDIM

### NE EMER TE REPUBLIKES

Sot me date 29.06.2015 Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore e perbere nga gjyqtari **KEN DHIMA**, asistuar nga sekretaria gjyqesore Kamila Petriti, shqyrtoi ne seance gjyqesore me dyer te hapura ceshtjen civile me nr 941 akti date 23.04.2015 qe i perket:

**PADITES :** “ED&AR” shpk, Lushnje, subjekt tatimor me NIPT J64103451Q, me adresë në Lushnje, Autostrada Lushnje-Fier përfaqësuar nga Adminitratori Z. Ardian Bami, ne mungese.

**IPADITUR :** 1- Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, perfaqesuar nga Bledar Myrselaj.  
2-Drejtoria e Apelimit Tatimor, prane Drejtorise se Përgjithshme Tirane, perfaqesuar nga Bledar Myrselaj.

**OBJEKTI:** Anullimin tërësisht të aktit administrativ “Njoftim Vlerësimi Detyrim Tatimor Nr:6761 Prot. datë 02.05.2014” për shumën detyrim dhe gjobë në masën 188 198 lek si akt të pavlefshëm.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 64, 65, 65/5 69, 71/1, 106 të Ligjit Nr:9920 datë 19/05/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 115,116/c,117,118 i K.Pr.Adminitrative dhe neni 43,47,327, 328 dhe 331 i Kodit Proçedurës Civile, Udhëzim Nr. 24 datë 02.09.2008“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr: 49/2012 “ Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimi mosmarrëveshje administrative”..

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te zhvilluar me dyer te hapura, gjykata pasi degjoi paditesin i cili kerkoi pranimin e padise sipas objektit dhe te paditurit i cili kerkoi rrezimin e padise dhe pasi shqyrtoi provat e administruara ne dosje dhe bisedoi ceshtjen ne teresi, si perfundim,

## VEREN

Se para Gjykates Administrative te Shkalles se pare Vlore paditësi "ED&AR" shpk ka paraqitur nje padi me objekt si me siper.

Gjykata cmon se ka juridiksion per gjykimin e kësaj ceshtjeje pasi per ceshtjen ne gjykim nuk parashikohet ne aktet ligjore e nenligjore ne fuqi ankim ne nje organ me te larte por drejtpersedrejti ne gjykate.

Gjykata cmon se kjo padi eshte ne kompetencen funksionale te kësaj gjykate konform nenit 10 te Ligjit Nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreshjeve Administrative".

Gjykata cmon se eshte ne kompetencen lendore te kësaj gjykate shqyrtimi i kësaj ceshtjeje pasi padia eshte nje prej atyre te parashikuara ne nenin 7 pika "ç" te Ligjit Nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreshjeve Administrative".

Gjithashtu gjykata cmon se eshte ne kompetencen tokesore te kësaj gjykate shqyrtimi i kësaj ceshtjeje pasi sipas nenit 11 pika 2 te Ligjit Nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreshjeve Administrative": Ne rastin te paditur jane Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, Drejtoria e Apelit Tatimore ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve Tirane .

Nga provat e administruara ne seance gjyqesore ka rezultuar se pala paditese shoqeria "ED&AR" shpk me NIPT J64103451Q, ushtron aktivitetin e tregtimit të pllaka, hidrosanitare, me vend ushtrimi aktiviteti në Lushnje, Autostrada Lushnje-Fier.

Gjykata veren se pala paditese eshte vene ne dijeni për njoftim vlerësimin për detyrimet tatimore me Nr. 6761 Prot. datë 02.05.2014 për gjobë, detyrim tatimor, gjobë kamat vonese në vlerën totale 188 198 lek.

Gjykata veren se ne lidhje me këtë njoftim vlerësimi për detyrimin tatimor paditësi i eshte drejtuar me ankim e datës 28.06.2014 Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

Gjate gjykimit pala paditese vertetoi faktin se eshte njoftuar në datë 27.08.2014 për vendimin me Nr.10178/1Prot datë 26.08.2014 nga Drejtoria Rajonale Tatimeve Fier me anë të sistemit postar ne te cilin thuhej se ankimi i saj nuk është pranuar.

Pala paditese duke kundërshtuar kete kthim pergjigje te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier,i eshte drejtuar Drejtorise se Apelit ne Drejtorine e

Pergjithshme të Tatimeve ne daten 05.02.2015 e cila i ka kthyer pergjigje me shkresen me Nr. 3000/1 Prot datë: 23.03.2015 ku i ka percaktuar se kerkesa e pages paditese nuk eshte pranuar.

Gjate gjykimit pala paditese vertetoi faktin se bazuar në Njoftim- Vlerësimin Nr. 6761 Prot, datë 02.05.2014 shoqëria është penalizuar me detyrimet tatimore si më poshtë:

Tatimi	Periudha	Detyrim	Gjoba	Kamatvonesë
SIGURIME	2009/09	78 957	29 739	31 184
TAP	2009/09	20 300	20 000	8 018

GJITHSEJ 188 198 LEKE

Pala paditese gjate gjykimit vertetoi faktin se i gjithë ky problem ka ardhur si pasojë e një gabimi të punonjësit të bankës që aksidentalisht, pagesën e ka transferuar të llogaria e Deklarimeve të Ardhurave të Drejtorisë së Tatimeve Tiranë. Ky gabim është sistemuar në fund të vitit 2009, pagesa ka kaluar në Drejtorinë e Tatimeve Lushnje në atë kohë, fakte të cilat janë të dokumentuar me shkresa përcjellese dhe mandat pagesat. Gjykata cmon se që nga ky moment që paditësi ka paguar detyrimin tatimor, ai çlirohet nga ky detyrim dhe nuk ka pse të ripaguaje për herë të dyte.

Gjykata verën se gjithmonë çdo fund viti "ED&AR" shpk është pajisur me situatat financiare nga Tatimet dhe nuk kanë qenë debitor asnjëherë për këtë vlerë sepse ndryshe pala paditese nuk do kishte sesi të pajisej me vërtetime dhe dokumenta tatimorë.

Gjykata verën se në bazë të Ligjit 9136 të 11.09.2003 Neni 11/a janë dorëzuar pranë bankës Formularët e Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi, dhe Kontributit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore.

Pala paditese vertetoi pagesën e detyrimeve të shoqëruara me mandat pagese, urdhër xhirimi të bankës përkatëse, dhe Formular Deklarimit të Pagesave (FDP) me vule dhe firmë.

Gjitashtu pala paditese vertetoi faktin se detyrimet janë të deklaruara ne bilancin 2009, te njohur si shpenzime gjithashtu sipas një Raport Kontrollit të ushtruar nga Tatimorët në bazë të nenit 80, ky detyrim nuk ka rezultuar i papaguar. Dhe njoftim detyrimi pas një kontrolli bie ndesh me ligjin. Rezultatet e kontrollit tatimor janë detyruese për administratën tatimore.

Gjykata cmon se nga debati gjyqësor rezultoi se edhe vetë përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier e pranon faktin që është bërë pagesa në sistemin bankar për këtë detyrim, kanë kaluar këto detyrime në sistemin tatimor por këto nuk paskan shkuar në adresë të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

Gjykata cmon se ky pretendim nuk është aspak i drejtë pasi nuk është faji i paditësit nëse sistemi elektronik i tatimeve nuk rakordon me vetveten.

Gjykata cmon se në zbatim të udhëzimit me nr.24 datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" detyrimi i tatimpaguesit mbaron me kryerjen e pagesës në sistemin bankar dhe plotësimin e formularit të detyrimit tatimor konform të dhënave të tij. Nga formulari dhe mandat pagesa

por edhe nga korrespondenca rezulton e provuar se detyrimi për periudhen shtator 2009 është paguar nga paditësi shoqëria "Ed&AR" shpk Lushnje Per sa me siper gjykates i duhet te vendose per pranimin e kerkesepadise si te bazuar ne prova dhe ne ligj duke vendosur anulimin tërësisht të aktit administrativ "Njoftim Vlerësimi Detyrim Tatimor Nr:6761 Prot. datë 02.05.2014" për shumën gjobë në masën 188 198 (njqind e tetedhjetë e tete mije e njeqind e nentedhjetë e tete) leke. Konform nenit 45 te ligjit nr. 49/2012 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative " ndaj ketij vendimi nuk lejohet ankim, prandaj ai merr forme te prere

### Per Keto Aresye

Gjykata bazuar ne Ligjin nr.49/2012. "Per organ'zinin dhe funksionimin e Givkatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative " Nenet 64, 65, 65/5 69, 71/1, 106 të Ligjit Nr:9920 datë 19/05/2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 115,116/c,117,118 i K.Pr.Adminitrative dhe neni 43,47,327, 328 dhe 331 i Kodit Proçedurës Civile, Udhëzim Nr. 24 datë 02.09.2008"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

### VENDOSI

1. Pranimin e kerkesepadise si te pabazuar ne prova dhe ne ligj.
2. Anullimin tërësisht të aktit administrativ "Njoftim Vlerësimi Detyrim Tatimor Nr:6761 Prot. datë 02.05.2014" për shumën gjobë në masën 188 198 lek
3. Ndaj ketij vendimi nuk nxirret urdher ekzekutimi.
4. Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te palve te paditura solidarisht.
5. Ky vendim eshte i ekzekutueshem nga permbarimi gjyqesor menjehere.
6. Vendimi eshte i formes se prere dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall ne Vlore, sot me dt.29.06.2015.

**SEKRETARË  
KAMILA PETRITI**



**GJYQTAR  
KENDHIMA**

